



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË
AGENCIJA ZA HRANU I VETERINARSTVO
FOOD AND VETERINARY AGENCY

Ref: AUV, 01/319/2023

Datë: 17.07.2023

Në mbështetje të nenit 22 dhe 23 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/23 Mars 2019), duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 2. 1, dhe nenin 1 5, të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, (08 qershor 2020), bazuar në neni 8, paragrafi 8.1, 8.2 dhe Listës së Programit të parë të Ligjit Nr. 2004/21 për Veterinarinë, Zv. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, mori këtë:

V E N D I M

Për ndalimin e lëvizjes së derrave në tërë territorin e Republikës së Kosovës, bazuar në këto masa:

- I. OBLIGOHEN** të gjitha Komunat në territorin e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me AUV-në dhe ambulancat veterinare në komunat përkatëse të ndër marrin këto masa:
- a) Ndalimin e lëvizjes së derrave nga fermat dhe tregëtimi i tyre në tregjet e kafshëve – shitëblerja e derrave;
 - b) Dezinfektimi i objekteve dhe zonave përreth ku ka shpërthim të sëmundjes;
 - c) Përcaktimi i zonave të mbrojtura (3 km) dhe gjurmueshmëria e sëmundjes (10 km);
 - d) Njoftimi i rasteve të dyshimta për sëmundjen Mortaja Afrikane e derrave - ASF;
 - e) Vizita e fermave të dyshuara dhe marrja e mostrave dhe dërgimi në Laboratorin e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe
 - g) Përcaktimi i lokacioneve dhe groposja e derrave të ngordhura.

- II. Përrjashtimisht nga pika I e këtij vendimi, lejohet lëvizja derrave nga fermat e lira nga kjo sëmundje në thertore të licencuara vetëm me pëlqimin e inspektorit veterinar të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.
- III. Për masat e lartëcekura të njoftohen Policia e Kosovës.
- IV. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Bekim Hoxha


Z.v Drejtor Ekzekutiv - AUV

Vendimi t'i dërgohet:

- DSHMK,
- Inspektoratit të AUV-së,
- Komunave në territorin e Republikës së Kosovës,
- Policisë së Kosovës dhe
- Arkivit të AUV-së..